



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

(Specialist)

Lloji i diplomës “SHKENCA HUMANE, SHKENCA SOCIALE DHE MESUESI”
Niveli minimal i diplomës “DIPLOME E NIVELIT TE PARE”

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhetë Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Roskovec shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit nëshërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

- ❖ 1(nje) Specialist Protokoll-Arkivi Bashkia Roskovec;
- ❖ 1(nje) Specialist Protokoll-Arkivi Njesia Administrative Kuman;
- ❖ 1(nje) Specialist Protokoll-Arkivi Njesia Administrative Kurjan
- ❖ 1(nje) Specialist Protokoll-Arkivi Njesia Administrative Strum

Shpallja eshte e hapur per te gjithe nepunesit civil te se njejtës kategori ne te gjitha institucionet pjese e shërbimit civil. Nese nuk ka nje fitues nga procedura e levizjes paralele, plotesimi i vendit vakant do te realizohet me procedurën e Pranimit në shërbimin Civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe Praniminë Shërbimin Civilnë kategorine (ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

LEVIZJE PARALELE: 02 Qeshor 2017

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 07 Qeshor 2017

Përshkrim i Përgjithshëm

Specialisti përgjigjet para Përgjegjësit të Sektorit të Arkivave dhe Dokumentacionit për menaxhimin e çështjeve që lidhen me fushën e veprimtarisë së sektorit në përputhje me ligjet, aktet nënligjore apo aktet rregullatore në fuqi.

DETYRAT

Detyrat Kryesore

- Ndjek arkivimin dhe përpunimin e korrespondencës dhe ruajtjen e fondit arkivor;
- Organizon punën në sektorin e arkivës për evidentimin, ruajtjen fizike, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve në bazë të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivin” dhe ligjin 8457, datë 11.2.1999
“Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”;
- Përpunon dokumentet e regjistruara, duke i sistemuar sipas dosjeve dhe drejtorive përkatëse;
- Kryen indeksimin e shkresave të ardhura në arkiv dhe kontrollon cilësinë e përpilimit të dosjeve;
- Punon për gjetjen e shkresave dhe dokumenteve që kërkohen nga drejtoritë e Bashkisë;
- Nxjerr nga arkiva dokumentet e kërkuara nga institucionet, qytetarët e sektorët e Bashkisë (vetëm me kërkesë zyrtare nga drejtori);
- Bën njehsimin e dokumenteve të ndodhura në arkiv me origjinalin, duke i sigluar ato në çdo faqe
- Merr në dorëzim të gjithë materialin arkivor dhe bën përpunimin e tij sipas kërkesave ligjore;
- Përpunon dokumentet e vitit të kaluar;
- Sistemon në arkiv fondin sipas strukturës dhe viteve përkatëse;
- Sistemon dokumentet e tenderit, të cilat dorëzohen në arkiv me përfundimin e praktikave të tyre, duke i marrë me inventar, një për një, me përgjegjësi, të cilat nxirren nga arkivi konform kërkesës së ligjit e rregullores së arkivit;
- Bën përpunimin e dosjeve dhe verifikon dosjet që iu ka mbaruar afati i ruajtjes, të cilat ia paraqet komisionit përkatës për asgjësim;
- Punon për sigurimin e kushteve teknike në arkivin e Bashkisë;
- Në bashkëpunim me arkivin vendor bën restaurimin e dokumenteve të dëmtuara gjatë viteve dhe

realizon dorëzimin e dokumenteve sipas afateve dhe kërkesave ligjore;

I. Levizja Paralele

Kjo procedurë është e hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunëscivil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën vlerësim e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Kriteret e vecanta për këto pozicione janë:

- a) të zotërojnë diplome minimumi 3-vjecare ,Diplomë “Bachelor”, në Shkenca Sociale, Shkenca Humane dhe Mesuesi. Nëse diploma është marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjisllacionit në fuqi
- b) të ketë të paktën 1 vit punë.
- c) Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj;

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njërezore, të Bashkisë Roskovecs, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njësuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje e vlerësimit të fundit vjetor.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë **02.06.2017**

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës së lëvizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifikë të vendit të punës do të dalin në datën **05.06.2017** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve.

Ankesat nga kandidatet paraqiten në Njësine e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore, brenda **3 ditëve** kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda **5 ditëve** kalendarike nga data e paraqitjes së saj.

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambjentet e Bashkisë Roskovec me datë

16.06.2017 ora 10:00

Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.139/2015 ‘Për vetqeverisjen Vendore’
- Ligj Nr. 9154, datë 06.11.2003 ‘Për Arkivat’
- VKM Nr. 390, datë 6.8.1993 ‘Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare’
- VKM Nr. 761, datë 19.11.2004 ‘Për krijimin e arkivit qendror për sistemin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit pranë institutit të sigurimeve shoqërore’
- VKM Nr. 157, datë 25.3.2005 ‘Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të këshillit të lartë të arkivave’
- VKM Nr. 158, datë 25.3.2005 ‘Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të komisionit qendror të ekspertizës, pranë drejtorisë së përgjithshme të arkivave’
- VKM Nr. 160, datë 25.3.2005 ‘Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të komisionit të përhershëm të ekspertëve, pranë drejtorisë së përgjithshme të arkivave’

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve: Kandidatët do të vlerësohen nga **Komisioni i**

Brendshëm për Lëvizjen Paralele ngritur në Bashkinë Roskovec, nëpërmjet

dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për çertifikimin pozitiv.
- b. **60 pikë** për intervistën me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve) në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohet parashikimi i pikës 13, të Kreut IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242 dt.18.03.2015 ‘Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese’

Komisioni në dt.**17.06.2017** njofton për vendimin e përzgjedhjes, Njësine Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njërëzore.

Njësia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore me datë **19.06.2017** shpall fituesin.

Njoftimi do të bëhet:

1. në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”
2. në faqen zyrtare të Bashkisë
3. nestenden e publikimeve të Bashkisë Roskovec.

II- Pranimi në Shërbimin Civil.

Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele nuk ka fitues, plotësimi i vendit vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë e kzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar:

Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndjaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar(hequr) sipas këtij ligji.

Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:

- a) të zotërojnë diplome minimumi 3-vjecare , Diplomë “Bachelor”, në Degët “Shkenca Sociale, Shkenca Humane, Mesuesi. Nëse diploma është marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- b) të ketë të pakten 1 vit punë.
- c) Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj;

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njëzore, të Bashkisë Roskovec këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës.Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave.Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.

- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë **07.06.2017**

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës së pranimit në shërbimin civil dhe të përmbushjes së kriterëve specifikë të vendit të punës do të dalin në datën **12.06.2017** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen e Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Gjithashtu, po në këtë datë kandidatët që nuk janë kualifikuar do të njoftohen nga Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerezore për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezore, Informacionit dhe Marrdhënieve me Publikun, brenda **5 diteve** kalendarike nga dhe ankuesi merr përgjigje brenda **3 diteve** pune nga data e depozitimit të saj.

Konkurimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë, do të zhvillohet në ambjentet e Bashkisë Roskovec në datën **21.06.2017 ora 10⁰⁰**.

Në konkurimin me shkrim dhe intervistë e strukturuar me gojë, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.139/2015 "Për vetqeverisjen Vendore"
- Ligj Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat"
- VKM Nr. 390, datë 6.8.1993 "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare"
- VKM Nr. 761, datë 19.11.2004 "Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit pranë institutit të sigurimeve shoqërore"
- VKM Nr. 157, datë 25.3.2005 "Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të këshillit të lartë të arkivave"
- VKM Nr. 158, datë 25.3.2005 "Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të komisionit qendror të ekspertizës, pranë drejtorisë së përgjithshme të arkivave"
- VKM Nr. 160, datë 25.3.2005 "Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të komisionit të përhershëm të ekspertëve, pranë drejtorisë së përgjithshme të arkivave"

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Roskovec.

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pike të cilat ndahen përkatesisht:

- 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të vlerësimit, për zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin "Specialist Protokoll-Arkivi".

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë, 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive".

Komiteti i Përhershëm i Pranimit brënda 24 (njëzet e katër) orëve, pra në dt.**22.06.2017** njofton listen e fituesve, Njesise pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njerezore.

Njesia pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njerezore më date **22.06.2017**, shpall listen e fituesve.

Njoftimi do të bëhet:

- në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit",
- në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec
- ne stenden e informimit publik.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne adresen Bashkia Roskovec.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail : evisa.mustafaj@yahoo.com

nr.tel: **0387 80242.**

NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

BASHKIA ROSKOVEC